

VENDIM
Nr. 191, datë 30.3.2022

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, NË FSHATIN GRYKË,
NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA
SHOQËRIA “NATYRAL ENERGY SYSTEM” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “*Natyrall Energy System*”, sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) emri i aplikuesit: “*Natyrall Energy System*” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: L93401402O;
- c) tipi i centralit: eolik;
- ç) kapaciteti i instaluar: 3 (tre) mw;
- d) afati i pritshëm i vënies në punë: koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 48 (dyzet e tetë) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;
- dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në fshatin Grykë, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier;
- e) afati i miratimit të ndërtimit: 48 (dyzet e tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;
- ë) koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuar prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate tremujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqëria “*Natyrall Energy System*”, sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht çdo 3 (tre) muaj pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucioneve të tjera të autorizuar prej saj informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;
 - ii. të respektojë kushtet e përmendura në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5 (pesë) % të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “*Natyrall Energy System*”, sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shoqëria “*Natyrall Energy System*”, sh.p.k., duhet t’i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;
 - v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

PLANVENDOSJA E SIPËRFAQES SË OBJEKTIT

